


AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI  
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

# PLANI STRATEGJIK

2017-2020

Qershor 2017



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI  
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT



*Empowered lives  
Resilient nations.*

Botimi u përgatit nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet  
e Ish-Sigurimit të Shtetit me mbështetjen e ekspertizës nga PNUD Shqipëri.

# Tabela e Përmbajtjes

<b>1. Përmbledhje ekzekutive .....</b>	<b>4</b>
<b>2. Deklarata dhe vlerat e misionit.....</b>	<b>5</b>
<b>3. Hyrje .....</b>	<b>6</b>
<b>4. Analiza kontekstuale.....</b>	<b>8</b>
<b>5. Qëllimet e Autoritetit.....</b>	<b>12</b>
5.1. Të sigurohet që publiku të fitojë aksesin në dosjet e ish-Sigurimit.....	12
5.2. Nxitja e kërkimit dhe e edukimit të publikut.....	15
5.3. Promovimi i transparencës dhe drejtësisë tranzicionale.....	18
5.4. Lehtësim i përdorimit nga institucionet publike dhe qytetarët që kandidojnë për poste publike.....	20
<b>6. Objektivat e Menaxhimit.....</b>	<b>22</b>

## 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit (në vijim "Autoriteti") është krijuar nëpërmjet ligjit nr. 45/2015: "Për të drejtën e informimit mbi dosjet e Ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë". Misioni i tij është të sigurojë akses në dosjet e Sigurimit dhe të ruajë të dhënat e shtypjes në mënyrë që të edukojë publikun dhe të mbështesë vlerat demokratike të drejtësisë, të vërtetën, pajtimin dhe përgjegjësinë për brezat e ardhshëm.

Për të përmbushur misionin e tij, Autoriteti udhëhiqet nga vlerat e transparencës, integritetit, bashkëpunimit, të mësuarit dhe angazhimit proaktiv. Ai i përgjigjet thirrjes së Parlamentit Evropian për të mbajtur gjallë kujtimin e së shkuarës, pasi nuk mund të ketë pajtim pa të vërtetë dhe përkujtim; Ai konfirmon edhe një herë qëndrimin e Shqipërisë kundër sundimit totalitar të çdo forme apo me çfarëdo lloj boshti ideologjik;

Respekton vlerat evropiane të të drejtave të njeriut dhe dinjitetit, lirisë, demokracisë, barazisë dhe shtetit të së drejtës.

Autoriteti synon të konsolidojë në një arkiv të vetëm të gjitha dokumentet e prodhuara nga Ish-Sigurimi i Shtetit; të sigurojë akses të rregullt në informacionin në dosje në përputhje me dispozitat e ligjit; të zhvillojë kërkime, seanca edukuese dhe kurrikula, dhe të angazhohet me publikun nëpërmjet komunikimit strategjik; si dhe skanimin e individëve që kandidojnë për poste publike për lidhje me Ish-Sigurimin e Shtetit.

Për të arritur këto qëllime, Autoriteti:

- do të identifikojë, mbledhë dhe krijojë një arkiv të integruar të të gjitha dokumenteve të njohura të përfuara nga veprimtaria e Ish-Sigurimit ose të lidhura me të;
- do të vendosë dosjet në dispozicion të publikut sipas dispozitave të parashikuara në ligj, duke përfshirë ofrimin e aksesit në informacion në formë dixhitale;
- do të ngrejë Autoritetin si një burim arkivor qendror, për hulumtimin mbi aktivitetet e Ish-Sigurimit;
- do të ndërjegjësojë publikun me synim ngritjen e Autoritetit si një platformë për angazhimin dhe kuptimin e së kaluarës komuniste në Shqipëri;
- do të mbështesë punën e dokumentimit të krimeve të komunizmit, duke përfshirë kontributin për drejtësinë;
- do të mbështesë procesin e identifikimit dhe rikuperimit të trupave të atyre që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë komunizmit;
- do të mbështesë verifikimin e pastërtisë së figurës (vetingun) së zyrtarëve që konkurrojnë për t'u zgjedhur ose emëruar në poste publike.

Ky mandat kërkon që Autoriteti të themelohet si një organ profesional efektiv me një personel të angazhuar dhe të kualifikuar, të aftë për të vendosur partneritete me homologë vendas dhe ndërkombëtarë.

Dokumenti i Strategjisë i paraqitur këtu për vitet 2017-2020 do të shërbejë si një dokument udhëzues për aktivitetet e Autoritetit të sapokrijuar. Ai ka për qëllim të drejtojë dhe përqendrojë aktivitetet e Autoritetit, duke mundësuar gjithashtu rishikime periodike të qëllimeve dhe objektivave të tij.

## 2. DEKLARATA E MISIONIT

Të informojë publikun shqiptar mbi veprimtarinë e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, gjatë diktaturës komuniste, të sigurojë akses të papenguar të qytetarëve në dosjet e Sigurimit që ruajnë të dhënat e shtypjes, në mënyrë që të mbështesin vlerat demokratike të drejtësisë, të vërtetën dhe përgjegjësinë për brezat e ardhshëm.

### Vizioni

Autoriteti do të ofrojë një platformë të besueshme për akses në trashëgiminë e madhe të dokumenteve të Ish-Sigurimit; për angazhimin e qytetarëve shqiptarë të çdo fushe duke i ofruar të dhëna, informacione dhe kontekstin nga arkivat e Sigurimit për përvojën e shtypjes gjatë komunizmit; dhe për funksionimin si një burim i aksesueshëm dhe vital për të vlerësuar të kaluarën e Shqipërisë nën sundimin komunist.

### Vlerat

- **Transparenca:** Krijimi i një atmosfere të hapur në të gjitha marrëdhëniet profesionale që promovojnë transparencën për të kaluarën
- **Integriteti:** Demonstrimi i angazhimit për ndershmëri dhe integritet në marrëdhëniet me publikun, zyrtarët dhe stafin
- **Bashkëpunimi:** Punë e përbashkët dhe kreative me individë dhe institucione që janë gjithashtu të përkushtuar për të drejtat e njeriut dhe hulumtimet objektive
- **Të mësuarit dhe angazhimi:** Ndërgjegjësimi i publikut përmes të mësuarit të vazhdueshëm si një mënyrë për të inkurajuar angazhimin demokratik

### 3. HYRJE

Autoriteti Shqiptar për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit (në vijim "Autoriteti") është një institucion i sapokrijuar nëpërmjet ligjit 45/2015, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë më 30 mars 2015. Ai udhëhiqet nga misioni e tij statutor për dhënien e informacionit mbi aktivitetet e Ish-Sigurimit të Shtetit (në vijim "Sigurimi") si dhe nga Rezoluta e Parlamentit Evropian, datë 2 Prill 2009, "Për ndërgjegjen evropiane dhe totalitarizmin". Autoriteti ka për qëllim të japë informacion mbi aktivitetet e Sigurimit; të rrisë ndërgjegjësimin e publikut për regjimin komunist në mënyrë që të ndihmojë në parandalimin e mostolerancës, ekstremizmit, lëvizjeve anti-demokratike dhe përsëritjen e sundimit totalitar në të ardhmen; dhe të inkurajojë një diskutim të hapur për të kaluarën komuniste dhe pasojat e saj.

Në punën e tij, Autoriteti përpiqet të respektojë të gjitha viktimat e regjimit totalitar dhe të nderojë ata që luftuan kundër tiranisë dhe shtypjes; i përgjigjet thirrjes së Parlamentit Evropian për të mbajtur gjallë kujtimin e së shkuarës, pasi nuk mund të ketë pajtim pa të vërtetë dhe pa përkujtim; konfirmon edhe një herë qëndrimin e Shqipërisë ndaj sundimit totalitar të çdo forme apo me çfarëdo lloj boshti ideologjik; respekton vlerat evropiane të të drejtave të njeriut dhe dinjitetit, lirisë, demokracisë, barazisë dhe shtetit të së drejtës.

Autoriteti do të konsolidojë në një arkiv të vetëm të gjitha dokumentet e prodhuara nga Sigurimi; do të sigurojë akses të rregullt në informacionin në dosje në përputhje me dispozitat e ligjit; do të zhvillojë seanca edukuese dhe kurrikula dhe do të vendosë partneritete me qendrat e tjera kërkimore dhe autoritetet publike, vendore dhe ndërkombëtare, që ndjekin qëllimet e drejtësisë tranzicionale dhe të kujtimit.

Ligji 45/2015 përcakton gjerësisht detyrat e institucionit si, sigurimin e grumbullimit dhe menaxhimit në një arkiv të vetëm të të gjitha dokumenteve në lidhje me veprimtarinë e Sigurimit duke garantuar akses në dosje, për të gjithë të prekurit. Ligji u hartua duke u bazuar në ligjin gjerman për aksesin në dosjet e STAS-it, të miratuar në fillim të viteve 1990 pas ribashkimit të Gjermanisë. Si në rastin e Gjermanisë, ligji 45/2015 bëri zgjedhjen e qëllimshme për të ndarë çështjen e aksesit në dosjet e Sigurimit nga ajo e lustracionit, e cila kishte shtrembëruar përpjekjet e mëparshme në vitet 1990 dhe 2000 për të sqaruar funksionimin e Ish-Sigurimit, duke shmangur kurthet kushtetuese dhe gjyqësore që kishin dëmtuar këto përpjekje ligjore të mëparshme, të cilat u shfuqizuan nga gjykatat vendore dhe ndërkombëtare.

Për të siguruar qëndrueshmërinë afatgjatë të ligjit, projektligji u orientua nga vendimi i vitit 2009 i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë dhe Komisionit të Venecias si dhe praktikat më të mira ndërkombëtare për mundësimin e aksesit në dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit. Gjithashtu, parashikon, deri në vitin 2020, verifikimin e pastërtisë së figurës së atyre që kërkojnë të emërohen në poste të larta në Shqipëri, duke i kërkuar Autoritetit që t'i përgjigjet të gjitha kërkesave institucionale dhe individuale për informacion mbi figurën e kandidatëve. Në këto raste, detyra e Autoritetit kufizohet në vënien në dispozicion të informacionit për kandidatin. Ai nuk vendos sanksione apo gjykon mbi përshtatshmërinë dhe denjësinë e individit që kandidon.

Sipas informacioneve paraprake, ekzistojnë mbi 20 milionë faqe të dokumenteve të Ish-Sigurimit që duhet të mblidhen në një arkiv dhe të menaxhohen nga Autoriteti. Këto dokumente aktualisht janë të shpërndara nëpër arkiva, zyra dhe agjenci të ndryshme, duke përfshirë Ministrinë e Brendshme,

Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shërbimin Informativ Shqiptar. Fondet e tjera të dokumenteve që lidhen me aktivitetet e Sigurimit mund të gjenden në arkivat e Ish-Komitetit Qendror të Partisë Komuniste, të PPSH-së, të depozituara në Arkivin Qendror të Shtetit. Në sistemin arkivor të Ministrisë së Drejtësisë dhe gjatë mund të ketë akoma edhe më shumë dokumente. Sipas informacioneve aktuale, të gjitha këto dokumente janë brenda ose jashtë Tiranës, dhe asnjë fond arkivor i prodhuar nga Sigurimi nuk mbetet në ndonjë nga degët lokale operacionale. Autoriteti do të kryejë një kërkim të thelluar për të siguruar që të gjitha dosjet ekzistuese të Sigurimit të transferohen dhe të ruhen në institucionin e ri. Sipas ligjit 45/2015 të gjitha institucionet dhe qytetarët duhet t'ia dorëzojnë Autoritetit çdo dokument, dublikatë apo dosje të Sigurimit që ata posedojnë.

Ndërsa të gjitha këto agjenci menaxhojnë koleksionet e tyre të dokumenteve, stafi i tyre institucional është i përgatitur për të siguruar organizimin e arkivave dhe rregulloren procedurale të nevojshme për të siguruar aksesin. Përveç kësaj, shpërndarja e arkivave nëpër agjenci të shumta me procedura të ndryshme për akses dhe katalogim, imponon vështirësi të jashtëzakonshme praktike në gjetjen dhe identifikimin e dosjeve specifike. Për rrjedhojë, edhe detyrimi ligjor për transparencë, i mandatuar nga ligji 45/2015, është i pamjaftueshëm për të siguruar aksesin pa mbledhjen, ruajtjen dhe menaxhimin e sigurt në një objekt të mbetjeve arkivore të Sigurimit. Institucionalizimi i transparencës është një nga përgjegjësitë më të rëndësishme ligjore të Autoritetit.

Detyra e mbledhjes së arkivave pranë Autoritetit do të kërkojë identifikimin e të gjitha dokumenteve të Sigurimit, kudo ku ato ruhen aktualisht, transferimin e tyre profesional dhe menaxhimin e sigurt për brezat që do të vijnë. Ndërkohë që konsolidimi i arkivave ekzistuese paraqet tashmë sfida logjistike në lidhje me transportin dhe organizimin, identifikimi i vazhdueshëm i dokumenteve të panjohura të ruajtura diku tjetër, verifikimi i integritetit të tyre dhe përpilimi i informacionit në dosjet që janë dëmtuar pjesërisht apo janë shkatërruar, paraqet një sfidë edhe më të madhe për Autoritetin, pasi kërkon t'i vendosë informacionet në dispozicion të publikut. Një arsye po aq e rëndësishme për unifikimin e dosjeve nën një menaxhim është parandalimi i keqpërdorimit të dokumenteve sensitive nga individët që mund t'i zotërojnë ato me anë të mënyrave të paligjshme ose formave të tjera.

Strategjia e paraqitur këtu për vitet 2017-2020, së bashku me Planin e Veprimit, do të shërbejë si një dokument udhëzues për aktivitetet e Autoritetit të sapokrijuar. Kjo strategji kërkon të përcaktojë qartë kontekstin në të cilin Autoriteti do të veprojë, të sigurojë një udhëzues për arritjen e qëllimeve dhe objektivave të tij komplekse, të përcaktojë detyra të qarta dhe të matshme për arritjen e këtyre qëllimeve dhe të paraqesë prioritetet strategjike për qëllime të mobilizimit të burimeve dhe partneritetit të grupeve të interesit. Kjo strategji nuk ka për qëllim të zëvendësojë përgjegjësinë vendimmarrëse të pesë anëtarëve të Autoritetit, Sekretariatit Teknik në ushtrimin e veprimtarisë mbështetëse të Autoritetit. Qëllimi i saj është t'u shërbejë anëtarëve të Autoritetit që kërkojnë t'u përgjigjen sfidave të krijimit të një institucioni të ri. Përcaktimi i detyrave reale dhe të matshme do të ndihmojë në përmirësimin e efikasitetit organizativ dhe do të ofrojë tregues të qartë për vetëvlerësim.

## 4. ANALIZA E KONTEKSTIT

Autoriteti po e fillon veprimtarinë e tij në një klimë të mungesës së besimit të publikut tek administrimi shtetëror i dosjeve të Sigurimit, pasi nismat e mëparshme ligjore janë ndërmarrë kryesisht për qëllime politike ose janë përballur me sfida kushtetuese dhe të drejtave të njeriut. Pra, suksesi i Autoritetit të ri varet nga aftësia e tij në krijimin e një reputacioni për integritetin, paanshmërinë dhe transparencën.

Që nga rënia e komunizmit në Evropën Lindore, përpjekjet për akses në dosjet sekrete të policisë zakonisht janë motivuar nga dy qëllime të ndryshme: lustracion dhe akses.<sup>1</sup> Nga viti 1990 deri në vitin 2015, iniciativat ligjore në Shqipëri i dhanë përparësi lustracionit. Asnjë nga këto përpjekje nuk pati sukses, duke rënë pre e sfidave ligjore (kushtetuese) dhe politike.

Një ligj i vitit 1993 për lustracionin në lidhje me profesionin e avokatisë, u refuzua nga Gjykata Kushtetuese. Ky dështim u pasua nga ligjet më të gjera deri më tani që kanë të bëjnë me dosjet e Sigurimit: Ligji “Për gjenocidin dhe krimet kundër njerëzimit kryer gjatë regjimit komunist për motive politike, ideologjike dhe fetare (“Ligji për gjenocidin”) dhe Ligji “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik (Ligji për Verifikimin)”, të dy të miratuar në vitin 1995. Ligji i vitit 2008 “Për pastërtinë e figurës së funksionarëve të lartë të administratës publike dhe personave të zgjedhur” pati një trajtim të ngjashëm me atë të vitit 1993: u pezullua nga Gjykata Kushtetuese, më pas mori kritika të mëtejshme nga Komisioni i Venecias i Këshillit të Evropës.

Si rezultat, pavarësisht përpjekjeve të hershme për transparencë, shumica e shqiptarëve nuk kanë akses në dosjet e Sigurimit. Me përjashtim të pjesshëm të Ligjit të Verifikimit (1996-2001), i cili shërbeu kryesisht për lustracion, shumica e personave të prekur nga Sigurimi nuk i kanë parë kurrë dosjet e tyre. Edhe ky ligj përfshinte vetëm shqyrtimin selektiv të autorizuar nga një komitet. Në vend të kësaj, aksesit ka qenë ose i kufizuar te përdoruesit e privilegjuar ose përdoret për kundërshtarët politikë<sup>2</sup>. Ky politizim i të dhënave të Sigurimit ka çuar, një çerek shekulli pas rënies së komunizmit, në një skepticizëm të përgjithshëm në lidhje me aftësinë e çdo agjencie shtetërore, përfshirë autoritetin e ri, për të hapur dosjet komuniste në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.

Ajo që e dallon ligjin 45/2015 për Autoritetin dhe përgjegjësitë që përcakton, nga përpjekjet e mëparshme është ndarja e çështjes së aksesit dhe transparencës nga ajo e lustracionit. Ky dallim ndihmon iniciativën nga çdo çështje e mospërputhjes me Kushtetutën, duke siguruar për herë të parë një proces ku çdo person i prekur nga veprimtaria e Sigurimit ka të drejtën dhe aftësinë për të parë atë informacion. Ndërsa ligji urdhëron verifikimin e kandidatëve sipas kërkesës, ky proces i kufizuar kryhet në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare, normat e rendit kushtetues dhe kufijtë e vendosur në Vendimin e Gjykatës së Strasburgut për të Drejtat e Njeriut dhe Rekomandimet e Komisionit të Venecias. Rrjedhimisht, roli parësor i Autoritetit është të sigurojë aksesin e qytetarëve në dosjet e Sigurimit dhe të nxisë një vetëdije më të madhe të funksionimit të diktaturës komuniste, njohuri që është thelbësore për ruajtjen e demokracisë së re të Shqipërisë.

1. Për historinë e përpjekjeve shqiptare për të trajtuar dosjet komuniste, shih Robert C. Austin dhe Jonathan Ellison, Drejtësia Tranzicionale Post-Komuniste në Shqipëri, Politikat dhe Shoqëritë e Evropës Lindore 22 (2008); Mark S. Ellis, Pastrimi i së kaluarës: gjendja aktuale e ligjeve të lustracionit në bllokun ish-komunist, Ligji dhe problemet bashkëkohore 59: 4, 1997, f.185-187; Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), Amicus Curiae Opinion mbi Ligjin mbi Pastërtinë e Figurave të Funkionarëve të Lartë të Administratës Publike dhe Personave të Zgjedhur të Shqipërisë, tetor 2009, f. 4-6.  
2. Robert C. Austin dhe Jonathan Ellison, Drejtësia Tranzitore Post-Komuniste në Shqipëri, Politikat dhe Shoqëritë e Evropës Lindore 22 (2008), 395.



Ligji 45/2015 është hartuar në vitin 2013 dhe është miratuar në mars të vitit 2015. Koha e ligjit është vendimtare. Ndërsa njëzet e shtatë vjet shënojnë një kalim të rëndësishëm që nga rënia e komunizmit, shumë njerëz të prekur nga aktivitetet e Sigurimit janë ende të gjallë, por edhe aktiv profesionalisht. Ata, megjithatë, janë në fazat e fundit të karrierës së tyre dhe është e rëndësishme që periudha pesëvjeçare e verifikimit të pastërtisë së figurës, e lejuar nga ky ligj - e kufizuar nga standardet evropiane dhe konventat për të drejtat e njeriut - të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur me qëllimin për të pasur rëndësi sociale dhe politike. Sipas ligjit aktual, dispozitat lidhur me verifikimin e kandidatëve përfundojnë në vitin 2020.

Është e rëndësishme në rishikimin e kontekstit të këtij ligji për të theksuar seriozitetin dhe kompleksitetin e futjes në dosjet e Sigurimit dhe interpretimin e gjetjeve të tij. Siç vërehet nga vetë ligji, mandati për të siguruar aksesin e qytetarëve zëvendëson dispozitat konkurruese që kanë të bëjnë me mbrojtjen e privatësisë ose dispozita të tjera ligjore përkatëse. Megjithatë, zbatimi i ligjit duhet të informohet nga korniza e përgjithshme ligjore në fuqi në vend.

Siç tregohet në literaturën e gjerë mbi drejtësinë tranzicionale, arritja e së vërtetës dhe qartësisë rreth krimeve të kaluara është thelbësore për nxitjen e pajtimit individual dhe kultivimin e besimit shoqëror të nevojshëm për të ruajtur demokracinë. Në të njëjtën kohë, dosjet e Sigurimit përmbajnë informacion që prek, komprometon dhe madje akuzon shumë persona që jetojnë ende. Fragmentet e lexuara jashtë tërësisë së kontekstit deformojnë pamjen e së kaluarës, në aspektin individual dhe atë shoqëror. Duke pasur parasysh pasiguritë në lidhje me besueshmërinë e informacionit të gjetur në dosje dhe vështirësitë e interpretimit të tij (të dyja çështje që diskutohen më poshtë), stafi i Autoritetit duhet të jetë vigjilent për balancimin e parimeve konkurruese të transparencës dhe privatësisë. Nëse ka konflikt, ligjet e transparencës mund të mbizotërojnë ndaj privatësisë së ish-bashkëpunëtorëve, megjithatë shumë diskutime rreth mënyrës së të kuptuarit të informacionit të gjetur në dosje do të jenë komplekse. Autoriteti dhe sekretariati mbështetës duhet t'i kapërcejë këto kompleksitete duke siguruar që qëllimi i ligjit të arrihet plotësisht.

Sfida e parë e interpretimit vjen nga paplotësia e arkivave. Gjatë viteve të fundit të komunizmit, agjentët e regjimit shkatërruan shumë dokumente duke dështuar në sigurimin e procedurave standarde të ruajtjes ose duke u përpjekur qëllimisht për të mbrojtur veten. Në disa raste, dosjet më kompromentuese mund të jenë shkatërruar. Përveç kësaj, me kalimin e kohës, shumë dokumenteve që datojnë në mesin e viteve 1940 u është dëmtuar letra dhe mikrofilmi. Kushtet jo optimale të ruajtjes kanë ulur cilësinë e dokumenteve. Prandaj, është e domosdoshme që Autoriteti në bashkëpunim me institucionet e tjera të ndërmarrin hapa të menjëhershëm për të parandaluar dëmtimin e mëtejshëm dhe për të siguruar ruajtjen e materialit arkivor ekzistues. Mangësitë e mundshme në dosjet e Sigurimit ndikojnë tek individët e prekur nga diktatura komuniste si dhe te kuptimi i plotë i historisë kombëtare të Shqipërisë në shekullin e njëzetë. Ligji aktual parashikon konsolidimin dhe ruajtjen e trashëgimisë dokumentare në dispozicion të Shqipërisë, duke përdorur praktikën më të mira ndërkombëtare për ruajtjen e dokumenteve, duke përfshirë dixhitalizimin.

Po aq e rëndësishme sa humbja e informacionit është sfida e paraqitur nga interpretimi i të dhënave që ekzistojnë. Dosjet e Sigurimit nuk mund të kuptohen siç duhet pa ngjyrimin e vetëdijes së kontekstit personal dhe shoqëror për çdo rast, megjithëse përgjithësisht nuk pasqyrohet në to. Për sa i përket interpretimit dy janë sfidat më të rëndësishme: shtrembërimi dhe motivimi. Ish-Sigurimi

kishte shumë arsye për shtrembërimin e informacionit rreth individëve në Shqipërinë komuniste, nga frika dhe karrierizmi deri te bindja ideologjike ose ligësia. Roli i tyre në mbikëqyrje dhe zbatim domosdoshmërisht e ka anashkaluar pikëpamjen e tyre për individët, duke çuar në mosmarrëveshje të thjeshta, ekzagjerime madje edhe tërësisht në gënjeshtër. (Shih tekstin ngjitur.) Për përdoruesit që i shohin për herë të parë dosjet e tyre, është e rëndësishme të kuptojmë se të dhënat që ato përmbajnë nuk mund të merren të mirëqena.

## Krahasimi Ndërkombëtar

Në Republikën Çeke, presidenti disident Václav Havel mësoi se dosja e tij e shërbimeve sekrete përmbante sugjerime të pavërteta se ai ishte një aleat ose informator i mundshëm për shkak të një rasti në të cilin ai nënshkroi një kërkesë për lirim nga burgu. Ky rast tregon mënyrat se si shërbimet sekrete komuniste mund të mashtrjnë njerëzit ose të shtrembërojnë informacionin në dosjet e tyre. Po ashtu, historiani dhe gazetari britanik Timothy Garton Ash gjeti disa mospërputhje me shënimet e ditarit të tij nga e njëjta periudhë kur shqyrtoi skedarin e tij Stasi (Shih librin e tij “The File: A Personal History” (1997)). Gabimet shkonin nga gabimet e thjeshta tipografike ose keqkuptimet e ngjarjeve dhe datave deri tek shtrembërimet ose trillimet e dukshme. Një ndër ankesat për ligjin e lustracionit të Çekosllovakisë, të miratuar në vitin 1991, ishte se në listën e zezë të individëve nga vende të caktuara pune, ai injoronte çështjet e motivimit individual dhe gabimeve në dosje. Duke i pranuar këto problematika, Gjermania zgjodhi një model aksesi pa lustracion në trajtimin e dosjeve të saj të Stasis. Ky është shembulli që ndjek ligji aktual shqiptar.

Sfida e dytë - ajo e motivimit të informatorëve - është edhe më e ndjeshme. Edhe në qoftë se ata që janë zbuluar në dosje kanë informuar siç tregohet, është shumë e rëndësishme të kuptohet se informatorët e Sigurimit kanë ofruar informacion për bashkëqytetarët për një sërë arsyesh. Disa vepruan për përfitime personale; të tjerë për shkak të kërcënimeve të mëdha për familjen dhe sigurinë e tyre. Këto motive mund të mos shfaqen në dosje, por ato janë thelbësore për t'u marrë parasysh kur vlerësojnë sjelljet e kaluara, veçanërisht për arsye se këto vlerësime do të ndikojnë në jetën dhe reputacionin aktual të këtyre personave nëse diskutohen në qarqet shoqërore ose në media. Pranimi i rrethanave lehtësuese mund të jetë sfidë më vete. Ata që hapin dosjet e tyre për herë të parë do të kenë me siguri një reagim emocional, (zemërim, ankth) kur lexojnë informacionin e mbledhur mbi ta dhe emrat e informatorëve. Mund të ketë më shumë tendencë për të dënuar se sa për të marrë në konsideratë kompleksitetet. Stafii duhet të punojë me përdoruesit gjatë këtij procesi delikat, duke respektuar intensitetin e reagimeve të tyre, por edhe duke interpretuar gjetjet në mënyra që respektojnë kompleksitetin e kontekstit dhe presionet ndaj njerëzve të tjerë. Kjo përpjekje do të kërkojë shumë mirëkuptim nga stafi.

Synimi i Autoritetit për t'i dhënë trajtë narrativës publike rreth Ish-Sigurimit dhe epokës komuniste përballet me sfida të ngjashme. Në një kohë kur pjesa më e madhe e popullsisë e konsiderojnë komunizmin si një periudhë tërësisht të zyrtë duke mos i dhënë më rëndësi, Autoriteti duhet të theksojë kontekstin dhe ndryshimin si dhe faktin se Sigurimi ka vepruar në forma të ndryshme gjatë periudhave të ndryshme. Periudha e terrorit flagrant dhe konsolidimit të regjimit në vitet 1945-1950

përfshinte strategji dhe taktika të ndryshme policore nga punonjësit e ruajtjes së rendit dhe shtypjes gjatë dekadave pasuese. Nga vitet 1970 deri në vitin 1990, veprimtaria e Sigurimit ndryshoi përsëri dhe u drejtua gjithnjë e më shumë kundër komunistëve të tjerë, si dhe popullsisë në përgjithësi. Nëse Autoriteti merr rolin e një gjyqtari të besueshëm në mosmarrëveshjet në lidhje me periudhën e komunizmit në Shqipëri, ai duhet të tregohet i kujdesshëm, objektiv, i gjithanshëm dhe konsistent gjatë prezantimeve, ekspozitave, kurseve, publikimeve dhe shfaqjeve mediatike. Përbushja e kësaj kërkesë duke i shërbyer njëkohësisht interesit të një publiku që është mësuar me prezantime të thjeshtuara mediatike, do të jetë një sfidë për anëtarët e Autoritetit dhe stafin.

Kjo balancë është edhe më sfiduese për shkak të dyshimeve që mbizotërojnë në lidhje me trajtimin e dosjeve komuniste nga shteti, për shkak të ligjeve të politizuara të përmendura më lartë. Si institucion shtetëror, Autoriteti do të duhet të punojë me përkushtim për të rindërtuar mbështetjen dhe interesin e publikut. Prej fillimit të aktiviteteve të tij, Anëtarët dhe stafi i Autoritetit duhet të demonstrojnë profesionalizëm, integritet dhe paanësi në marrëdhëniet e tyre publike dhe private. Nuk ka pothuajse fare hapësirë për lapsuse apo gabime. Megjithatë, reputacioni si një organ me integritet mund të rezultojë shumë i vlefshëm për Autoritetin, duke e lejuar atë të fitojë besim në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare; të krijojë partneritete me institucione të respektuara dhe që gjenerojnë të ardhura; dhe, më e rëndësishmja, të forcojë demokracinë e Shqipërisë duke u përballur me të kaluarën e trazuar.

## 5. QËLLIMET E AUTORITETIT

### 5.1. Sigurimi i aksesit në dosjet e Sigurimit

Qëllimi kryesor i Autoritetit është të sigurojë të drejtën e çdo qytetari për të parë informacionin e gjeneruar ose të mbledhur për ta nga Ish-Sigurimi. Në rrethana të caktuara, të afërmit mund të shohin dosjet e një anëtari të familjes të ndarë nga jeta ose të zhdukur. Qytetarët do të jenë në gjendje të sigurojnë akses në këto dosje pas dorëzimit të një kërkesë tek Autoriteti të shoqëruar me një dokument identiteti, në zbatim të dispozitave ligjore për të mbrojtur të drejtën e privatësisë së çdo pale të tretë dhe për të siguruar respektimin e të drejtave të njeriut dhe dinjitetit të të gjithë personave. Ofrimi sa më i shpejtë i aksesit në këto dokumente mbetet prioriteti kryesor i Autoritetit.

Megjithatë, mbrojtja e të drejtës për akses nuk është e njëjta gjë me garantimin e aksesit të njerëzve në dosjet e tyre. Qëllimi i mundësimit të aksesit arrihet vetëm kur Autoriteti arrin të kontaktojë personat të cilëve duhet t'u shërbejë. Për ta bërë këtë, Autoriteti duhet të ketë mjaftueshëm personel, burime dhe trajnime për t'u shërbyer në mënyrë efikase atyre që kërkojnë të hyjnë në dosjet e tyre. Përveç kësaj, ai duhet të ketë personelin dhe aftësitë e duhura për menaxhimin e marrëdhënieve me publikun dhe ndërgjegjësimin e këtij të fundit, pasi personat e interesuar nuk do të angazhohen me Autoritetin, nëse nuk janë të informuar për shërbimet apo nuk kanë besim tek aftësitë e tij. Kështu, ndërgjegjësimi i publikut është po aq i rëndësishëm për qëllimin e sigurimit të aksesit sa dhe shërbimi ndaj klientit.

**Objektivi strategjik 1.1** - Identifikimi, mbledhja dhe krijimi i një arkivi të integruar të të gjitha dokumenteve të njohura të përfuara nga veprimtaria e Ish-Sigurimit ose të lidhura me të.

#### Detyrat:

Veprimi		Treguesi
1	Identifikimi i dosjeve ekzistuese në vendndodhje të ndryshme	Lista e plotë e dosjeve në vendndodhje të njohura
2	Vlerësimi i gjendjes së dosjeve	Raport mbi gjendjen aktuale të dokumenteve të njohura
3	Sigurimi i autorizimit për zhvendosjen e dosjeve/ materialeve në një vendndodhje të re (Ndërtesa e Autoritetit)	Marrëveshjet zyrtare me agjencitë përkatëse për të transferuar autoritetin mbi dosjet e dokumenteve
4	Transportimi i dokumenteve në ndërtesën e rikonstruktuar të Autoritetit	Inventari i plotë i dosjeve në vend
5	Përpunimi i dokumentacionit të pakataloguar/ painventarizuar të përfuar nga ose lidhur me Sigurimin dhe integrimi i dokumentacionit në Sistemin Arkivor të Autoriteteve	Identifikimi i dokumentacionit arkivor të pakataloguar/painventarizuar; nënshkrimi i marrëveshjeve me fondet arkivore përkatëse për të kataloguar/ inventarizuar dhe për të transferuar materialin përkatës tek Autoriteti <sup>3</sup>
6	Hartimi i një plani për ruajtjen e të dhënave materiale	Plani i zhvilluar i ruajtjes
7	Hartimi i një plani për organizimin dhe katalogimin e të dhënave për aksesueshmërinë, duke përfshirë një analizë historike të strukturës së dosjeve të Sigurimit	Plani i zhvilluar i organizimit dhe analizës historike
8	Hartimi i një plani për dixhitalizimin	Plani i hartuar

**Objektivi strategjik 1.2** – Vendosja e dosjeve në dispozicion të publikut sipas dispozitave të parashikuara në ligj, duke përfshirë sigurimin e aksesit në informacion në formë dixhitale.

**Detyrat:**

Veprimi	Treguesi	
1	Organizimi dhe katalogimi i dokumenteve materiale sipas standardeve ndërkombëtare të arkivave dhe bibliotekave	Inventari i dosjeve të organizuara me katalog të përfunduar
2	Hartimi i një plani dixhitalizimi dhe dixhitalizimi i dokumenteve sipas aksesit, prioritetit të ruajtjes dhe burimeve në vend.	Dokumentet e dixhitalizuara të disponueshme në терминаlet kompjuterike
3	Zhvillimi i manualeve të përshtatshme për përdoruesit për përdorim të materialeve dhe dokumenteve dixhitale.	Manualet e zhvilluara
4	Identifikimi i një fokus-grupi të vogël për testimin beta të ndërfaqes së përdoruesit dhe manualeve	Ndërfaqja e rishikuar e përdoruesit dhe manualet
5	Zhvillimi i politikave të referencës dhe aksesit për publikun bazuar në ligjin 45/2015, i cili përcakton se kush mund të ketë akses në dosje dhe si	Dokument i plotësuar i politikave
6	Zhvillimi i procedurave për mbrojtjen e identitetit të palëve të treta (duke fshirë emrat, etj.)	Procedurat e zhvilluara
7	Hartimi i rregullave për përdorimin e dokumenteve të aksesueshme si dhe për kopjimin e dokumenteve	Tërësia e rregullave të hartuara
8	Zhvillimi i materialeve hyrëse për prezantim për të gjithë përdoruesit të cilat shpjegojnë rregulloret e aksesit, rregullat, kontekstin dhe sensitivitetin e dokumenteve, duke përfshirë faqet e nënshkrimit që kërkohen për autorizimin e përdorimit.	Tërësia e shkresave që do të vihen në dispozicion të secilit përdorues të dosjeve
9	Trajnimi i stafit për rregullat dhe politikat	Regjistrimet e seancave të zhvilluara të trajnimit; vlerësimi i seancave të trajnimit
10	Nisja e një fushate ndërgjegjësimi në lidhje me të vërtetën dhe transparencën, si dhe shërbimet e ofruara nga Autoriteti. Organizimi i një konference shtypi rreth nisjes së procesit duke përfshirë përgatitjen e një njoftimi për shtyp dhe publikimin e tij në të gjitha mediat në Shqipëri.	Reklama, shkrime gazetash/konferenca, ngjarje, evente, postime të rrjeteve sociale të përdorura për të reklamuar punën e Autoritetit
11	Krijimi i një Bordi Këshillues të Autoritetit i përbërë nga individë të profil të lartë nga profesione të ndryshme	Themelimi i Bordit Këshillues; regjistrimi i organizimeve të ndërgjegjësimit publik nga Autoriteti

**Diskutimi i sfidave**

Ndër sfidat kryesore që lidhen me sigurimin e aksesit në arkivat e Sigurimit, janë ndjeshmëria e jashtëzakonshme që lidhet me funksionimin e shërbimit të sigurimit dhe ndikimin social të transparencës së re. Për shumë shqiptarë që qenë viktime të shtypjes së Sigurimit, të hedhësh dritë mbi të kaluarën është thelbësore për mbylljen e një etape në planin psikologjik, si për individin ashtu edhe për familjet. Për Shqipërinë në tërësi, besimi dhe kohezioni shoqëror i domosdoshëm për ruajtjen e demokracisë në një shoqëri ku ish-viktimat dhe autorët e këtyre krimeve jetojnë krah për krah, kërkon ballafaqim me fantazmat e së kaluarës<sup>4</sup>.

3. Në partneritet me italianët, UNDP ka restauruar dhe kataloguar arkivat e Marubit, duke krijuar ekspertizë në vendruajtje për rigjenerimin dhe restaurimin e dokumenteve të vjetra.

4. Literatura e gjerë rreth Gjermanisë pas Luftës së Dytë Botërore dëshmon rëndësinë e transparencës historike për të hedhur themelet e një demokracie të fortë.

Në të njëjtën kohë, megjithatë, zbulimet nga dosjet mund të hapin plagë të vjetra, si në planin individual ashtu dhe për shoqërinë në tërësi. Ligji 45/2015 bën dallimin ndërmjet “bashkëpunëtorëve”, “personave të favorizuar” dhe “personave të prekur”, kategori ligjore që duhet të përcaktohen qartë gjatë veprimtarisë. Megjithatë, për qëllime interpretimi, dallimet janë edhe më të vogla. Njerëzit kanë shërbyer si informatorë dhe kanë bashkëpunuar në mënyra të ndryshme dhe për arsye të ndryshme. Ndërsa disa shfrytëzuan postet e tyre dhe kryen shkelje të rënda për përfitime personale, të tjerë mund ta kenë bërë këtë me detyrim, nga frika për familjet, sigurinë ose jetën e tyre. Pavarësisht se këto rrethana nuk e justifikojnë bashkëpunimin, ato sigurojnë kontekst të rëndësishëm në një shoqëri ku mbizotëronin kërcënimet dhe frika. Stafi i Autoritetit duhet t'i kushtojë vëmendje mënyrës se si i paraqiten këto çështje kontekstuale aplikantëve që kërkojnë të shikojnë dosjet e tyre, pasi zbulimet nga dosjet mund të çojnë në karakterizime (konkluzione- përfundime) të padrejta ose të njëanshme të veprimeve dhe motiveve të njerëzve gjatë komunizmit.

Një problem i dytë, i përmendur edhe më sipër, është çështja e informatave të paplota ose të rreme në dosje. Dokumente të panumërta u shkatërruan në muajt dhe vitet para dhe pas rënies së komunizmit, pasi zyrtarët e regjimit dhe agjentët e Sigurimit kërkuan dhe filluan të fshijnë dosjet e inkriminimit. Përveç kësaj, dokumentet e prodhuara gjatë katër dekadave të komunizmit janë dëmtuar dhe përkeqësuar si rezultat i kohës dhe magazinimit jo në përputhje me standardet e kërkuara. Së fundi, dhe ndoshta më së shumti, dosjet e Sigurimit përmbajnë paragjykime dhe shtrembërime serioze. Shërbimet sekrete shpeshherë i përdornin provat në mënyrë selektive, duke fabrikuar ose ekzagjeruar pretendimet dhe duke i filtruar informacionet nëpërmjet këndvështrimit të shtrembëruar të një programi mbikëqyrjeje në një shtet totalitar. Ndërsa dosjet janë një burim tepër i rëndësishëm për të kuptuar të kaluarën komuniste, informacioni i tyre nuk duhet të merret i mirëqenë.

Ligji 45/2015 mbron privatësinë dhe identitetin e palëve të treta, të përcaktuara në dosjet personale, por u lejon qytetarëve të shohin emrat e atyre që kanë informuar apo spiunuar për ta.

<sup>1</sup>Literatura e gjerë rreth Gjermanisë pas Luftës së Dytë Botërore dëshmon rëndësinë e transparencës historike për të hedhur themelet e një demokracie të fortë.

Prandaj, do të jetë detyrë e anëtarëve dhe stafit të Autoritetit të zhvillojnë procedura të qarta për interpretimin e dykuptimësive dhe paqartësive të dokumenteve për aplikantët që shohin dosjet e tyre personale, në mënyrë që ata të mos nxjerrin konkluzione të nxituara për bashkëqytetarë të përmendur si informatorë.

Ka gjithashtu, natyrisht, një seri sfidash politike dhe logjistike të lidhura me konsolidimin e arkivave. Krijimi i një reputacioni për profesionalizëm, integritet dhe evitim të politikës do të jenë elementët kryesorë që do të përcaktojnë aftësinë e Autoritetit për të përmbushur mandatin e tij ligjor. Ky reputacion mund të fitohet vetëm me kalimin e kohës përmes ofrimit të shërbimeve efektive. Shtrirja e shërbimeve tek të gjithë shqiptarët që përfitojnë nga veprimi i Autoritetit përmes veprimtarive të mirëkuptimit dhe planifikimit të mirëfilltë publik do të luajë një rol po aq të rëndësishëm. Por këto duhet të organizohen me kujdes, në partneritet me mediat, universitetet dhe organizatat e tjera, në mënyrë që të theksohen jo vetëm shërbimet e ofruara, por edhe vlerat e Autoritetit të ri dhe si këto vlera ndryshojnë nga përpjekjet e mëparshme në lustracion dhe akses në dosje.

Përveç kësaj, mund të ketë probleme të mosmarrëveshjeve juridike, pasi agjencitë kundërshtojnë kthimin e fondeve të dokumenteve (dhe vendeve të punës që ata mbështesin) një autoriteti të ri të pavarur. Mund të ketë gjithashtu komplikime në lidhje me zbatimin e kërkesës që qytetarët e zakonshëm të kthejnë dokumentet që posedojnë. Të dyja këto detyra do të kërkojnë negociim të

kujdesshëm dhe sqarim publik në mënyrë që të shuajnë çdo frikë të tejkalimit të qëllimit ligjor të autoritetit.

Si përfundim, do të jetë me rëndësi që mbi bazën e rrethanave financiare dhe logjistike si edhe të nevojës të përcaktohet nëse do të jetë e nevojshme të nënkontraktohen disa prej detyrave teknike që kërkohen për të ngritur arkivin (metodika bibliotekare, dixhitalizimi, teknikat e ruajtjes së dokumenteve, printimi, programimi kompjuterik, historia publike) ose të kontraktohet staf i agjencisë dhe të blihen pajisjet për t'i realizuar ato.

## **5.2. Nxitja e kërkimit dhe e edukimit të publikut**

Qëllimi i dytë i Autoritetit është të mbështesë të drejtën e institucioneve akademike, studiuesve dhe përfaqësuesve të medias për të konsultuar të dhënat e Sigurimit me qëllim promovimin e hulumtimeve rigoroze dhe objektive mbi të kaluarën e Shqipërisë dhe për të siguruar edukimin e publikut në përgjithësi. Kjo qasje do të garantohet në kushte që sigurojnë respektimin e të drejtave të njeriut dhe privatësinë e individëve të përmendur në dosje. Autoriteti do të mbështesë punën kërkimore që ndihmon në rivlerësimin e aktivitetit të Ish-Sigurimit dhe vlerësimin e ndikimit të aktivitetit të tij në historinë e Shqipërisë nën komunizëm. Përveç kësaj, Autoriteti do të angazhohet në edukimin e publikut, duke iu drejtuar atij përmes aktiviteteve të tilla si Dita e Përkujtimit të Viktimave të Ish-Sigurimit të Shtetit, përmes partneriteteve me shkollat dhe Ministrinë e Arsimit dhe përmes platformave sociale dhe tradicionale të medias.

Hulumtimi aktiv dhe axhenda e edukimit të publikut, mund të ndihmojë në pozicionimin e Autoritetit brenda peizazhit më të gjerë akademik vendas dhe ndërkombëtar. Në vitet e para të veprimtarisë së tij, Autoriteti duhet të marrë parasysh përcaktimin e fushave me interes të veçantë kërkimor dhe nënshkrimin e Memorandumeve të Mirëkuptimit për bashkëpunim me hulumtuesit, universitetet dhe organizatat që punojnë në këto fusha. Gjithashtu ai mund të organizojë konferenca, kurse edukative dhe botime të rëndësishme për komunizmin në Shqipëri, si dhe të lidhet me rrjetet më të gjera kërkimore që përqendrohen në të drejtat e njeriut, trashëgiminë komuniste dhe totalitarizmin ndërkombëtar. Gjatë këtyre përpjekjeve, do të jetë vendimtare për t'i garantuar Autoritetit dhe bashkëpunëtorëve të tij një reputacion të mirë në analizat komplekse të ngjarjeve dhe trashëgimive historike.

**Objektivi strategjik 2.1** - Themelimi i Autoritetit si një burim arkivor qendror për kërkime mbi aktivitetet e Sigurimit.

**Detyrat:**

Veprimi	Treguesi	
1	Përcaktimi i fushave kërkimore që Autoriteti dëshiron të mbështesë	Përshkrimi i listës së fushave kërkimore
2	Krijimi i bashkëpunimit me universitete, arkiva dhe qendra kërkimore, brenda dhe jashtë vendit, që punojnë në këto fusha kërkimore	Memorandume Mirëkuptimi ose Letra Bashkëpunimi
3	Ngritja e një politike aksesi për studiuesit, duke përfshirë rregullat për akses dhe përdorimin e dokumenteve (plani duhet të adresojë llojin e projekteve të përkrahura, kërkesat për akses, rregullat mbi privatësinë dhe citimin, dhe rregullat për përdorimin fizik të dorëshkrimeve)	Politika e zhvilluar me dokumentet përkatëse për përdorim
4	Krijimi i një dhome leximi ku dokumentet mund të përdoren nën mbikëqyrje	Dhoma e leximit e pajisur me terminale kompjuterike, tavolina dhe pajisje të tjera
5	Ndërtimi i një biblioteke në terren me materiale plotësuese - si fizike ashtu edhe në internet - të rëndësishme për studimin e Sigurimit, komunizmit në Shqipëri dhe sundimin totalitar në përgjithësi	Krijimi i bibliotekës
6	Zhvillimi i materialeve reklamuese dhe i katalogut online në pronësi të Autoritetit. Vendosja e dokumenteve të përzgjedhura online dhe përcaktimi i niveleve të duhura të aksesit nga jashtë.	Materialet e zhvilluara (broshura, pamflete, etj.) dhe katalogjet e bibliotekës. Ngarkimi i skedarëve të zgjedhur dhe krijimi i protokolleve të aksesit.
7	Reklamimi i gjetjeve në universitete dhe qendra kërkimore brenda dhe jashtë vendit	Numri i studiuesve dhe institucioneve që raportojnë për njohjen e Autoritetit
8	Shqyrtimi i mundësive për grante ndërkombëtare që mundësojnë hulumtime në qendrën e sapokrijuar	Propozimet e financimit; dhe së fundmi, grantet
9	Komisionimi i një historiani-studiuuesi vendas për të shkruar një studim të shkurtër të rëndësishëm të materialeve arkivore dhe kërkimit në këto arkiva; përkthimi në gjuhën angleze dhe gjuhë të tjera sipas nevojës	Studimi i përfunduar
10	Marrja në konsideratë e organizimit të konferencave dhe serive të botimeve	Konferencat e organizuara dhe botimet e realizuara
11	Puna me ambasadat shqiptare dhe konsullatat jashtë vendit për t'u shtrirë tek universitetet lokale, institutet kërkimore, OJQ-të, dhe emigrantët shqiptarë	Memorandumet e Mirëkuptimit me ambasadat shqiptare; regjistrime të eventeve të ambasadave dhe konsullatave lidhur me Autoritetin



**Objektivi strategjik 2.2** - Kryerja e veprimtarive informuese në terren për t'a prezantuar Autoritetin si një platformë për angazhimin publik dhe kuptimin e së kaluarës komuniste në Shqipëri

**Detyrat:**

Veprimi	Treguesi	
1	Vendosja e ekspozitës në ndërtesën e Autoritetit të hapur për publikun	Ekspozita e hapjes bashkë me katalogun e ekspozitës
2	Zhvillimi i një plani përhapjeje mediatike me materiale, duke përfshirë broshurat, mesazhet dhe imazhet; konsideroni krijimin e një Klubi Mediatik me gazetarë të specializuar në këto çështje	Plani i zhvilluar i medias me materialet shoqëruese (materialet e printuara, njoftimet për shtyp, postimet elektronike dhe gazetat, blogjet etj.); Themelimi i Klubit Mediatik
3	Zhvillimi i një Plani të Informimit dhe Strategjisë së Komunikimit për grupet përkatëse të interesit publike dhe private (agjencitë publike, OJQ-të, universitetet) si dhe audiencat e huaja (duke përdorur ambasadat dhe seksionet konsullore)	Plani i zhvilluar, me listat e materialeve (materialet e printuara, postimet elektronike dhe gazetat, blogjet etj.) dhe ngjarjet që synojnë audiencat të ndryshme
4	Zhvillimi i Planit të Medias Sociale për Autoritetin, duke përfshirë planet për Aplikacionet, Facebook, Instagram, LinkedIn, Twitter, si dhe programet e pasdites dhe mbrëmjes	Plani i zhvilluar me materialet shoqëruese
5	Kryerja e informimit dhe ndërgjegjësimin edukativ në shkolla, duke përfshirë futjen e çështjeve të transparencës historike në kurset e “qytetërimit”	Anketimi në shkolla; Memorandum Mirëkuptimi me Ministrinë e Arsimit
6	Kryerja e aktiviteteve të angazhimit të qytetarëve, familjeve dhe të të rinjve, si Dita e Përkujtimit të Viktimave	Regjistrimi i ngjarjeve
7	Identifikimi i stafit, anëtarëve të Bordit dhe vullnetarëve për të kryer aktivitete në terren (aktivitete dhe kokë më kokë)	Lista e përgjegjësive të stafit
8	Hartimi i një liste emailësh të personave dhe organizatave të interesuara (vendase dhe të huaja) dhe shpërndarja e rregullt e broshurave dhe informacionit përkatës	Lista e emaileve e krijuar dhe regjistri me emaile dhe përgjigje
9	Krijimi i partneriteteve me muzetë dhe mediat	Memorandume Mirëkuptimi ose Letra Bashkëpunimi
10	Zhvillimi i më shumë ekspozitave, kurseve edukative, dhe projekteve filmike që lidhen me posedimet dhe interesat e Autoritetit	Ekspozita të reja, kurse, skica të projektit

**Diskutimi i sfidave**

Sfidat për arritjen e këtij qëllimi kanë një natyrë më shumë teknike sesa politike. Themelimi i Autoritetit si qendër kërkimore do të kërkojë burime të përshtatshme për të punësuar stafin e duhur, konsulentët ose firmat kontraktuese; kultivimin e ekspertizës teknike në metodikat bibliotekare, në historinë publike dhe në fushatat mediatike; dhe krijimin e një reputacioni të padiskutueshëm për integritetin dhe rigorozitetin akademik. Çelësi do të jetë kultivimi i partneriteteve ndërmjet organizatave që synojnë të rrisin profilin, reputacionin dhe kapacitetet e Autoritetit.

Themelimi i Autoritetit si një qendër për angazhimin publik, kërkon një përpjekje tjetër nga ajo që synon forcimin e reputacionit të tij si një qendër kërkimore dhe Autoriteti mund të zgjedhë t'i japë përparësi gjatë vitit të dytë të veprimtarisë së tij. Përbushja e së parës kërkon shtrirje të gjerë më shumë te qytetarët shqiptarë sesa tek universitetet, studiuesit dhe qendrat kërkimore dhe rrjedhimisht përfshin fushata dhe aktivitete publike që synojnë të nxjerrin në pah punën dhe temat e Autoritetit dhe të afirmojnë praninë e tij në shoqërinë civile shqiptare. Veçanërisht i dobishëm në këtë fushë do të jetë bashkëpunimi me media të ndryshme, të reja dhe tradicionale (media sociale, televizion etj.)

### 5.3. Promovimi i transparencës dhe drejtësisë tranzicionale

Nëse qëllimi i dytë përqendrohet në hulumtimet në të kaluarën - funksionet tradicionale të një muzeu ose arkivi, qëllimi i tretë i Autoritetit është që të shërbejë në më shumë funksione ligjore dhe gjyqësore: të hedhë dritë mbi krimet e së kaluarës; të mbështesë procesin e identifikimit dhe rikuperimit të eshtrave të viktimave të Ish-Sigurimit; dhe të lehtësojë pajtimin, rehabilitimin dhe drejtësinë tranzicionale. Ai përforcon të drejtën për të kërkuar drejtësi nga të gjithë të prekurit nga aktivitetet e Ish-Sigurimit.

Autoriteti do të shqyrtojë çdo provë që sugjeron shkelje të rënda të të drejtave të njeriut gjatë periudhës komuniste, duke përfshirë krimet kundër njerëzimit dhe do të bashkëpunojë me institucionet e zbatimit të ligjit në hetimin e plotë të këtyre krimeve. Do të ndërmarrë iniciativa që lehtësojnë respektimin e së vërtetës dhe pjesëmarrjen kuptimplotë të publikut, duke përfshirë gratë, në dialogun kombëtar për drejtësinë tranzicionale. Do të ndihmojë në iniciativat për të identifikuar personat e vrarë ose të zhdukur, për të rehabilituar viktimat dhe për të hedhur dritë mbi abuzimet me të drejtat e njeriut dhe krimet e kryera nga anëtarët e regjimit të mëparshëm. Ndërsa këto shërbime janë fokusuar në trajtimin e krimeve të së kaluarës, ato janë thelbësore për konsolidimin e demokracisë shqiptare për brezat e ardhshëm, pasi kuptimi i krimeve dhe abuzimeve të së kaluarës është i nevojshëm për t'i shmangur ato në të ardhmen.

Si pjesë e kësaj përpjekjeje, Autoriteti duhet të themelohet si një qendër e rëndësishme për të drejtat e njeriut dhe drejtësinë tranzicionale në Shqipëri. Për këtë qëllim, ai duhet të lidhet me rrjetin e gjerë ndërkombëtar të organizatave të të drejtave të njeriut dhe drejtësisë tranzicionale në nivel ndërkombëtar. Kjo shtrirje lidhet por dallon nga hulumtimi dhe përfshirja në angazhimet publike të trajtuara në Objektivin 2. Vendosja e lidhjeve me organizatat e të drejtave të njeriut mund të jetë mënyra më efektive për profilizimin ndërkombëtar të Autoritetit pasi këto organizata shpesh kanë procese më të qarta dhe më të shpejta partneriteti në krahasim me universitetet dhe institutet kërkimore, që mund të kërkojnë më shumë kohë për t'i kultivuar. Kështu, nëse në vitin e parë Autoriteti dëshiron t'i japë prioritet përhapjes në shkallë ndërkombëtare, mund të dëshirojë të bashkëpunojë me organizatat që punojnë në fushat e të drejtave të njeriut dhe të drejtësisë tranzicionale, duke lejuar që lidhjet dhe hulumtimet të vazhdojnë me hap më të ngadaltë.

Objektivi strategjik 3.1 - Mbështetja e punës së dokumentimit të krimeve të komunizmit, duke përfshirë kontributin në vënien e drejtësisë.

#### Detyrat:

Veprimi	Treguesi	
1	Identifikimi i organizatave vendase dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që punojnë në drejtësinë tranzicionale, si dhe i organeve të pavarura si Avokati i Popullit dhe komitetet e konventave përkatëse në të cilat Shqipëria është palë	Tabela e përfunduar e organizatave me interesa dhe kontakte tematike të parashtruara; përfshirja e anëtarëve të stafit përgjegjës për të vendosur kontakte (tabela e përgjegjësisë)
2	Zhvillimi i materialeve që paraqesin zotimet e Autoritetit në aspektin e të drejtave të njeriut	Fletëpalosje e përgatitur për shpërndarje në organizata të të drejtave të njeriut

<b>3</b>	Krijimi i partneriteteve me organizatat e të drejtave të njeriut të interesuara për krimet e komunizmit	Marrëveshje bashkëpunimi me organizatat përkatëse
<b>4</b>	Nisja e praktikës për të ftuar një sërë folësish për çështjet që lidhen me Sigurimin dhe komunizmin shqiptar	Identifikimi dhe ftesa për folësit; çështjet e diskutuara
<b>5</b>	Organizimi i një konference në vitin e parë që fton ekspertët vendas dhe ndërkombëtarë, gazetarët dhe organizatat e interesuara për të drejtat e njeriut dhe trashëgiminë komuniste	Konferencë; program; dërgimi i ftesave
<b>6</b>	Zhvillimi i një fushate për informim në media përqendruar në vlerën e drejtësisë tranzicionale	Plani i medias, reklamat, dëshmi informimi dhe partneriteti me mediat përkatëse

**Objektivi strategjik 3.2** - Mbështetja e procesit të identifikimit dhe rikuperimit të eshtrave të viktimave që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë komunizmit (Nevojiten ndryshime ligjore)

#### Detyrat:

Veprimi	Treguesi	
<b>1</b>	Themelimi i një protokollit familjar për Autoritetin, duke përfshirë procedurat e veçanta, broshurën dhe personelin	Politikat dhe protokollin e kompletuar, së bashku me dokumentet shoqëruese për t'u shpërndarë me publikun
<b>2</b>	Përfshirja e informacioneve për gjetjen e të zhdukurve dhe identifikimin e eshtrave gjatë fushatës së ndërgjegjësimit për të drejtat	Plani për një fushatë ndërgjegjësimi për të drejtat e shkelura në vend
<b>3</b>	Krijimi i lidhjeve me organizata të tjera shtetërore dhe lokale të nevojshme për të kryer identifikimin e personave të zhdukur	Memorandume Mirëkuptimi ose forma të tjera partneriteti
<b>4</b>	Nxjtja e lidhjeve me profesionistë ligjorë, psikologë dhe media, të cilëve familjet mund t'u referohen sapo identifikimi të jetë përfunduar	Listat referuese
<b>5</b>	Parashikimi i procedurave ligjore për vërtetimin e vdekjes, transferimin e eshtrave dhe transferimin e objekteve personale, në rast se identifikimi është përfunduar	Politika për konfirmimin e eshtrave; referime në zyrat përkatëse ligjore

#### Diskutimi i sfidave

Autoriteti është gati të bëhet një agjenci udhëheqëse në fushat e drejtësisë tranzicionale dhe pajtimit familjar me anë të fondit të dokumenteve arkivore në dispozicion. Megjithatë, ai nuk mund t'i përmbushë i vetëm detyrat e nevojshme për arritjen e këtij qëllimi. Kështu, në vitet e para, stafi i Autoritetit duhet t'i kushtojë vëmendje krijimit të partneriteteve dhe marrëdhënieve të punës me organizatat përkatëse, brenda dhe jashtë vendit. Kjo do të kërkojë jo vetëm Memorandume Mirëkuptimi zyrtare, por edhe një përmbledhje të qartë të hapave në proceset e informimit të medias, ndihmës lidhur me personat e humbur dhe ndihmës psikosociale.

Në nivel ndërkombëtar, duhet të rrisë përpjekjet aktive për të kultivuar marrëdhëniet me OJQ-të ndërkombëtare (si Qendra Ndërkombëtare për Drejtësinë Tranzicionale (ICTJ)) dhe të angazhohet në konferenca dhe informacione/publikime që shpjegojnë gjendjen e vendit dhe punën e Autoritetit për një audiencë më të gjerë globale.

## 5.4. Lehtësimi i përdorimit nga institucionet publike dhe qytetarët që kandidojnë për poste publike

Një qëllim i katërt i Autoritetit është që të sigurojë verifikimin e pastërtisë së figurës së kandidatëve që kandidojnë për poste të larta. Me kërkesë të institucioneve shtetërore ose individëve që konkurrojnë ose kërkojnë të emërohen në detyra të larta publike, Autoriteti do të shqyrtojë dokumentet që disponon, për të përcaktuar, nëse ekzistojnë dëshmi që tregojnë se këta persona kanë bashkëpunuar me Ish- Sigurimin e Shtetit. Autoriteti nuk rekomandon sanksione ose pasoja bazuar në gjetjet e tij. Është përgjegjësi e autoritetit publik që bën kërkesën të vendosë se cilat pasoja duhet të nxirren nga rezultatet në bazë të statuteve të tyre përkatëse. Ky qëllim do të mbetet në fuqi deri në vitin 2020, kur ligji për verifikimin e figurës të përafrohet me ligjin evropian.

Autoriteti dëshiron të nisë një fushatë ndërgjegjësimi me agjencitë qeveritare dhe partitë politike për të sqaruar procesin e verifikimit të pastërtisë së figurës dhe për ta përcaktuar atë si një normë për tre vitet e ardhshme, në mënyrë që të mos përdoret më shumë nga një agjenci apo parti. Nëse njëra parti e përdor shërbimin për të demonstruar pastërtinë e saj, ndërsa një tjetër e shmang atë nga frika e përbaltjes, dosjet rrezikojnë të politizohen. Megjithatë Autoriteti nuk mund t'i shmangë tërësisht këto çështje, është thelbësore që stafi të insistojë në kompleksitetin dhe nuancat e kërkuara për të interpretuar gjetjet në dosjet e tij.

**Objektivi strategjik 4.1** - Mbështetja e verifikimit të zyrtarëve që konkurrojnë për t'u zgjedhur ose emëruar në poste publike.

### Detyrat:

Veprimi	Treguesi	
1	Krijimi i partneritetit me Komisionin e Zgjedhjeve për të vëzhguar procesin e verifikimit si dhe me çdo agjenci tjetër përkatëse që shpjegon vlerën e mundshme të verifikimit	Marrëveshjet e partneritetit
2	Zhvillimi i procedurave për verifikimin e pastërtisë së figurës së kandidatëve, duke përfshirë përcaktimin e informacionit që mund të përfshihet në raportet dhe formatin e prezantimeve të raportit	Politika e plotë e verifikimit
3	Zhvillimi i përkufizimeve operacionale për dallimet në ligjin 45/2015 ndërmjet "bashkëpunëtorit", "personit të favorizuar" dhe "personit të prekur".	Publikimet e përkufizimeve të qarta
4	Hartimi i një kërkesë formale për verifikim të pastërtisë së figurës dhe shpërndarja e saj për përdorim në agjencitë përkatëse	Formularët e kompletuar dhe të shpërndarë
5	Qartësimi i afatit deri në vitin 2020 të funksionit të verifikimit të pastërtisë së figurës nëpërmjet njoftimeve publike dhe faktit se Autoriteti ofron vetëm informacione, por nuk përcakton pasojat	Fushata publike dhe takimi me agjencitë dhe palët e prekura
6	Ndërgjegjësimi i të gjitha agjencive të mundshme të përdoruesve dhe partive politike për atë se çfarë mund dhe nuk mund të bëjë ky shërbim	Lista e takimeve dhe ngjarjeve për ngritjen e vetëdijes; regjistrimi i përdorimit të këtij shërbimi, i ndarë sipas agjencisë kërkuese, partisë dhe individit

## **Diskutimi i sfidave**

Funksioni i Autoritetit për verifikimin e pastërtisë së figurës është një nga fushat e menjëhershme të veprimit, por është gjithashtu një nga më të ngarkuarit, pasi i ngjan më shumë ligjeve të pasuksesshme të lustracionit të dekadave të fundit. Autoriteti duhet të jetë gjithmonë vigjilent që verifikimi i pastërtisë së figurës të mos politizohet si lustracioni në të kaluarën. Duhet të jetë i kujdesshëm për të monitoruar përdorimin e shërbimit nga agjencitë dhe kandidatët e ndryshëm për të siguruar që nuk duhet të favorizojë asnjë subjekt, veçanërisht një parti në krahasim me një tjetër. Kjo ishte një nga pengesat e ligjeve të së kaluarës dhe politizimi mund të çojë në dyshime dhe mosbesim të përsëritur në radhët e segmenteve të popullsisë shqiptare.

Në të njëjtën kohë, Autoriteti ka për detyrë ta paraqesë informacionin siç është në dosjet arkivore, pa marrë parasysh përkatësinë në ndonjë agjenci apo parti të personave të përmendur. Balancimi i nevojës për vërtetësi me dëshirën për barazi dhe paanësi relative do të jetë vendimtare, veçanërisht nëse zbulimet e arkivave kompromentojnë më shumë njëri parti. Duke marrë në konsideratë këtë shqetësim, ligji e ngarkon Autoritetin me përgjegjësi për verifikimin e figurës por jo për sanksionimin. Po aq i rëndësishëm mbetet fakti se, Autoriteti nuk e nis procedurën e verifikimit të pastërtisë së figurës derisa të bëhet kërkesa nga subjekti. Megjithatë, mbështetja vetëm në këtë mandat për të siguruar një reputacion paanshmërie nuk është e mjaftueshme, ndaj stafi i Autoritetit duhet të vëzhgojë me vëmendje përdorimin e këtij shërbimi dhe në mënyrë aktive të inkurajojë të gjitha partitë dhe agjencitë që ta përdorin atë pa e politizuar.

## 6. OBJEKTIVAT E MENAXHIMIT

Përveç objektivave që lidhen me katër qëllimet e Autoritetit, ekzistojnë tre objektiva të menaxhimit të cilave duhet t'i kushtojmë vëmendje. Disa prej tyre janë diskutuar në qëllimet programore të mësipërme, por ato i kanë të gjitha qëllimet dhe funksionet e Autoritetit.

### Objektivi 1 - Themelimi i autoritetit si një organ profesional efektiv

Për të përmbushur misionet e tij të shumta dhe për të tërhequr punonjës cilësorë, Autoriteti duhet të veprojë si një organizatë kolegjinale dhe e decentralizuar e cila bazohet në ekspertizën e anëtarëve të ndryshëm dhe u lejon atyre të veprojnë me një shkallë të lartë autonomie. Ndryshe nga strukturat drejtuese hierarkike apo piramidale, ku personeli vepron duke kryer (përmbushur) vendimet e marra nga drejtuesi, stafi i Autoritetit, duke përfshirë pesë Anëtarët, stafin e Sekretariatit Teknik dhe ekspertët e tjerë, do të jetë mjaft i pavarur brenda fushave profesionale të ekspertizës. Në mënyrë që Autoriteti të vazhdojë të jetë një organ profesional efektiv, ai duhet të vendosë protokolle të qarta për marrjen e vendimeve, bashkëpunimin në projekte dhe zgjidhjen e konflikteve në mënyrë kolegjinale dhe jo hierarkike. Kjo sfidë menaxheriale kërkon balancimin e vendimmarrjes efikase me shpërndarjen e autoritetit ndërmjet ekspertëve të stafit.

Veprimi		Treguesi
1	Hartimi i manualit të punonjësit me seksione në lidhje me punësimin, zgjidhjen e kontratës, vendimmarrjen, zgjidhjen e konflikteve dhe fusha të tjera përkatëse	Manuali i punonjësit
2	Zhvillimi i takimeve me anëtarët e stafit për të shpërndarë manualin	Anketim i anëtarëve të stafit për t'u siguruar që i njohin politikën e manualit të punonjësit
3	Vendosja e linjave të qarta të dialogut dhe inputeve të punonjësve për politikën e Autoritetit	Deklarata e politikave
4	Zhvillimi i një plani të qartë menaxhimi, me planin e personelit që përfshin rolet dhe përgjegjësitë	Plani i menaxhimit

## Objektivi 2 - Përmirësimi i angazhimit, zhvillimit dhe produktivitetit të punonjësve

Mandati i zgjeruar i Autoritetit kërkon një gamë të gjerë të ekspertizës së stafit, nga njohuria e ligjit, historisë, politikës dhe literaturës për të drejtat e njeriut deri tek aftësitë teknike në teknologji informacioni, ruajtjen e dokumenteve, metodika bibliotekare dhe informimin e medias, secila një fushë e veçantë studimi me veçoritë e veta profesionale. Për të tërhequr dhe mbajtur një numër të mjaftueshëm personeli të kualifikuar, Autoriteti bazuar në legjislationin e shërbimit civil, duhet të zhvillojë politika të qarta dhe progresive të personelit që inkurajojnë zhvillimin dhe iniciativën profesionale, bashkëpunimin brenda dhe përtej organizatës dhe angazhimin me publikun e gjerë. Këto politika dhe praktika duhet ta bëjnë Autoritetin një vend të përshtatshëm për të punuar, ku stafi i ekspertëve mund të zhvillojë interesat profesionale ndërkohë që punon për misionin e përgjithshëm të institucionit. Krijimi i një strukture menaxhuese efikase dhe jo hierarkike, e trajtuar në Objektivin 1, është një faktor në tërheqjen e punonjësve të kualifikuar. Po aq i rëndësishëm është zhvillimi i politikave të burimeve njerëzore që inkurajojnë autonominë dhe bashkëpunimin; dhe strategjitë e rekrutimit që synojnë kandidatët më të kualifikuar në fusha të ndryshme.

Veprimi		Treguesi
1	Hartimi i një liste të qartë të nevojave prioritare për rekrutim për vitin e parë	Lista e nevojave
2	Kryerja e njoftimeve për pozicionet përkatëse si dhe shpërndarja e tyre në universitetet, OJQ-të dhe agjencitë përkatëse	Njoftimet dhe evidencat e shpërndarjes; punësimet
3	Pjesëmarrja rregullisht në evente (konferenca, takime të agjencive, forume të OJQ-ve) ku punonjësit potencialë të ardhshëm mund të takohen	Regjistrimet e personave që kanë marrë pjesë
4	Zhvillimi i politikave të qarta të personelit si pjesë e manualit të punonjësit, bazuar në një studim të institucioneve vendase dhe të huaja me qëllime dhe mandate të ngjashme	Politikat e manualit të punonjësit

### Objektivi 3 - Përdorimi i asetëve për ndërtimin e partneriteteve dhe burimeve

Përveç personelit, Autoriteti ka nevojë për burime kur është fjala për të arritur qëllimet e tij. Fushatat e mediave, konferencat e hulumtimeve dhe botimet, ruajtja e dokumenteve dhe ekspozitat, të gjitha kërkojnë fonde të mjaftueshme dhe reputacion të fortë. Meqenëse qeveria siguron vetëm 25% të buxhetit të saj të parashikuar, Autoriteti duhet t'i kushtojë kohë dhe burime të stafit të tij mbledhjes së fondeve. Përfitimi i burimeve të tjera të financimit, siç janë grantet, mund të ndihmojnë gjithashtu që Autoriteti të ketë pavarësi të mjaftueshme për të qenë në gjendje të ndërmarrë projekte dhe partneritete kur lindin mundësi. Çelësi për këtë përpjekje për mbledhjen e fondeve do të jetë vendosja e partneriteteve me universitetet vendase dhe të huaja, fondacionet, OJQ-të, organizatat e të drejtave të njeriut dhe agjencitë financuese. Këto marrëdhënie jo vetëm që mund të çojnë në financime të reja por mund të rrisin reputacionin e Autoritetit si një qendër rigoroze për promovimin e kërkimit, e të drejtave të njeriut dhe të ndërgjegjësimit publik. Rritja e reputacionit që vjen nga një pozitë më e mirë ndërkombëtare do të ndihmojë në rritjen e mundësive për financim, gjë që do të kontribuojë më tej në një shtrirje më të madhe (një rreth virtuoze). Një vendim që Autoriteti mund të dëshirojë të marrë në konsideratë në vitin e ardhshëm është nëse duhet të krijojë një sektor të veçantë me punonjës të përkushtuar për hartimin e propozimeve për grante dhe mbledhjen e fondeve, apo nëse i gjithë stafi duhet të parashikojë një përqindje të caktuar të kohës së tij për përpjekjet për zhvillim.


Veprimi		Treguesi
1	Vendimmarrja nëse do të krijohet një sektor për zhvillim/ mbledhje fondesh	Krijimi i sektorit dhe punësimi i personelit; ose deklarimi i qartë i përgjegjësive të mbledhjes së fondeve nga stafi i Autoritetit
2	Vendosja e marrëdhënieve me universitetet e jashtme, OJQ-të dhe agjencitë vendase dhe të huaja	Memorandume Mirëkuptimi (MM) ose marrëveshje të tjera partneriteti
3	Mbledhja e fondeve të jashtme për plotësimin e nevojave	Sasia e fondeve të mbledhura gjatë vitit të parë nga xxx subjekte të jashtme
4	Ngritja e profilit të Autoritetit në vend dhe në rang ndërkombëtar	Regjistrimi i përdorimit dhe citimit të burimeve dhe ekspertizës së Autoritetit nga organizatat ndërkombëtare











AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI  
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHËTËTIT